



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERET PUBLIKE

Nr. ____ prot.

Tiranë, më 16.10.2019

Lënda: Parashtrimet e Komisionerit Publik në seancën gjyqësore pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, datë 16.10.2019, për çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit z. Besnik Muçi

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues!

Në vijim të vendimit të ndërmjetëm, në seancën gjyqësore të datës 1.10.2019, për marrjen si provë të dokumentit të përcjellë nga ana e DSIK-së, si dhe shkresës së datës 10.10.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, drejtuar Institucionit të Komisionerëve Publikë dhe subjektit të rivlerësimit, z. Muçi, në vijim paraqesim qëndrimin e Komisionerit Publik në lidhje me përmbajtjen e kësaj prove të administruar, tashmë e deklasifikuar plotësisht sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi për deklasifikimin e informacionit të klasifikuar: “sekret shtetëror”.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi në tërësi i përmbajtjes së informacionit të DSIK-së, i cili në thelb përmban dokumentacion të përcjellë nga ana e Drejtorisë Gjyqësore e Prokurorisë së Përgjithshme, për personat e tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, rrethanat dhe faktet e paraqitura në të, në vështrim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, mund të shërbejnë në vlerësimin tërësor të çështjes dhe procedurave rivlerësuese për subjektin e rivlerësimit.

Konstatojmë se personat e tjerë të lidhur me subjektin, të proceduar penalisht për veprat penale të përmendura në këtë informacion, nuk përmbushin kushtet për t’u cilësuar si persona të përfshirë në krimin e organizuar e, për rrjedhojë, të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë, e të vetme, në vlerësimin e kriterit të figurës për subjektin e rivlerësimit, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuar në nenin DH, të aneksit të Kushtetutës.

Por Komisioneri Publik çmon se ky informacion, në konsideratë të raportit dhe të marrëdhënieve të pranuara edhe nga vetë subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ të Komisionit, sikurse dhe nga rrethanat e dala nga vlerësimi i kriterit për kontrollin e pasurisë, ku provohet se subjekti ka pasur marrëdhënie interesi dhe pasuror me personin tjetër të lidhur, që rezulton i proceduar penalisht, shtetasi ***.***, sikurse deklaron dhe në deklaratën Vetting, detyrim ndaj këtij shtetasi në vlerën 21.000 euro, mund të shërbejë si rrethanë dhe argument se subjekti i rivlerësimit mund të vihet lehtësisht nën presionin e strukturave kriminale, në referim të nenit 37, germa “c”, të ligjit nr. 84/2016.

Gjithsesi, vlerësimin e kësaj rrethane, raportin dhe ndikimin që ajo ka në vlerësimin tërësor të çështjes dhe të procedurave rivlerësuese për subjektin e rivlerësimit, Komisioneri Publik ia lë në çmim këtij Trupi të Nderuar.

KOMISIONERI PUBLIK

Darjel SINA